Ramazani

Si **hyn** muaji i Ramazanit?

1 Shikimi i hënës së re të muajit Ramazan

Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Agjëroni kur ta shihni atë (hënën e re) dhe ndërpriteni agjërimin kur ta shihni atë" (El-Bukhari 1800, Muslimi 1081), pra nënkuptohet pamja e hënës së re. Nëse **një musliman i logjikshëm, i pjekur,** i drejtë, që gëzon një eksperiencë dhe garanci të besueshme, e shikon **hënën e re të Ramazanit, kësisoj konfirmohet hyrja e muajit** dhe njerëzve u obligohet të nisin agjërimin e Ramazanit.

Hyrja e Ramazanit fiksohet **me një prej dy gjërave**

2 Plotësimi i Shabanit 30 ditë

Sepse muaji hënor është ose 29 ose 30 (ditë) dhe nuk është më shumë se kaq. Nëse muaji Shaban i plotëson 30 ditë, kuptimi i kësaj është se ka filluar muaji Ramazan. Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Agjëroni kur ta shihni atë (hënën e re) dhe ndërpriteni agjërimin kur ta shihni atë. Nëse ajo ju mbulohet, atëherë plotësojeni numrin e (ditëve të) Shabanit 30 (ditë)" (El-Bukhari 1800, Muslimi 1081).

Ku referohemi për hyrjen e muajit Ramazan dhe Bajramit?

Nëse muslimanët janë pakicë në një vend jomusliman, **ata ndjekin atë që thonë qendrat dhe shoqatat islame.** Nëse shoqatat dhe qendrat islame ndryshojnë, muslimani obligohet të ndjek qendrën islame të qytetit të tij ku ai jeton, ose xhaminë e madhe në qytet, ose xhaminë ku ai falet, dhe kështu, në përpjekje që të bashkohet me bashkësinë (muslimane) sa të mundet

Tek njoftimi zyrtar i vendit ku jetojnë muslimanët
I Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "Ngrënia juaj (e ligjëruar) është në ditën në të cilën ju çelni (bashkëirsht) dhe kurbanet tuaja janë në ditën në të cilën ju i bëni kurbanet" (Ebu Daud 2324, Et-Tirmidhi 697).

Vlerat e tij (Ramazanit)

Nata e Kadrit

Për të cilën Allahu ka treguar në Librin e tij se vepra e mirë në të është më e mirë se vepra në kohëra të shumta, duke thënë: "Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj" (El-Kader, 3). Personit që falet në të me besim (tek Allahu) dhe për shpërblim (prej Tij), do t'i falet gjynahu i kaluar. Ajo është një prej 10 netëve të fundit të Ramazanit që fillon prej ezanit të akshamit dhe mbaron me daljen e sabahut. Askush nuk e di prerazi kohën e saj dhe kjo me qëllim që të përpiqemi në të gjitha netët.

Kuptimi "1000 muaj"

Thuhet se kjo vjen me kuptimin e dukshëm, pra (nata e Kadrit) është e barasvlershme me 1000 muaj

Thuhet edhe se me sa në fjalë nënkuptohet hiperbola në spikatje të shpërblimit dhe vlerës së saj të madhe, dhe se me 1000 synohet shtimi kulmor dhe mirësia e pakufi e Allahut

Zbritja e Kuranit

Ai është muaji që Allahu e veçoi për zbritjen e librit më madhështor dhe më të nderuar: Kuranit fisnik. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për mugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le ta agjëronjë!" (El-Bekare: 185).

Hapen dyert e Xhenetit dhe prangosen shejtanët

Në të hapen dyert e Xhenetit dhe lidhen me zinxhirë shejtanët: Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Kur Ramazani hyn, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe shejtanët lidhen me zinxhirë" (El-Bukhari 3103, Muslim 1079). Allahu e ka përgatitur Ramazanin për robërit e Tij që t'i aviten atij duke punuar vepra të mira dhe braktisur veprat e refuzuara

Falja e mëkateve përmes agjërimit dhe faljes së natës

Kush e agjëron ditën e tij dhe falet në natën e tij, do t'i falet gjynahu i tij i shkuar

Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Personit që e agjëron Ramazanin me besim (tek Allahu) dhe për shpërblim (prej Tij),do t'i falet mëkati i tij i shkuar" (El-Bukhari 1910, Muslimi 760).

Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Personit që falet në netët e Ramazanit me besim dhe për shpërblim, do t'i falet mëkati i tij i shkuar" (El-Bukhari 1905, Muslimi 759).

Beteja Ajn Xhalut

H 658

Ajo është një betejë vendimtare e udhëhequr nga sulltan Kutuzi dhe komandanti ushtarak Bejbers, që i dha fund invazionit (zaptimit) mongol të vendeve muslimane. Ajn Xhalut gjendet në veri të Palestinës. Ndodhi më 25 ramazan të vitit 658 hixhri ose 1260 e.s.

Çlirimi i Amurijes (Amorium)

H 223

Ku kalifi abasit El-Mua'tesim u nis me një ushtri të madhe në ndihmë të një gruaje muslimane e cila iu drejtua atij për ta ndihmuar, kundër agresionevë të forcave kryqtare të udhëhequra nga Theophilus (i biri i) Michaelit. El-Mua'tesim e rrethoi Amurijen - që është një territor i Turqisë së sotme - dhe përmes tij Allahu e çliroi atë më (17 ramazan 223 hixhri/12 gjatë 838 e.s.).

Çlirimi i ishullit të Sicilisë

H 212

Ky ishull gjendet në jug të Italisë dhe është çliruar përmes udhëheqësit kadiut Esed Ibn El-Furat (Allahu e mëshirofshi!) i cili bie dëshmor nga plagët e marra në betejë. Qeverisja islame në të vijoi për më se dy shekuj e gjysmë ku u përhapën shkenca, civilizimi dhe arkitektonika. Ndodhi më 9 ramazan të vitit 212 hixhri, ose 6 dhjetor të vitit 827 e.s.

Çlirimi i territoreve të Andaluzisë

H 92

Fitore e muslimanëve të udhëhequr nga Tarik Ibn Zijad, pas një beteje të madhe kundër mbretit (barbar) Roderik, që do të ishte rreludi i epokës së shkencës, civilizimit dhe tolerancës për 8 shekuj. Ndodhi më 28 ramazan të vitit 92 hixhri – 19/7/711 e.s.

Çlirimi i Mekes

H 8

Ku i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të!) hyri (në Meke) pa luftë, kokular prej modestisë dhe nënshtrimit ndaj Allahut, dhe lexoi: "Thuaj: "E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket"!" (El-Isra: 81). Ndodhi më 20 ramazan të vitit 8 hixhir ose 10/1/630 e.s.

Ramazani i parë në të cilin obligohet agjërimi

H 2

Ramazani i parë në të cilin u obligua agjërimi ishte në vitin 2 hixhri ose 624 e.s. dhe kjo përmes fjalës së Allahut të Lartësuar: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat" (El-Bekare: 183)

Zbritja e Kuranit

ق . هـ
١٣

Zbritja e Kuranit mbi shkëlqesinë tonë Muhamedin (Paqja qoftë mbi të!) filoi në shpellën e Hirasë, në malin që sot njihet me emrin mali Nur, i cili gjendet në afërsi të Mekës. Filloi kur Xhebrail (Paqja qoftë mbi të!) zbriti me suren e parë "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)" (El-Alak: 1). Ndodhi ditën e hënë më 21 ramazan ose 10 gusht të vitit 610, në vitin 13 para hixhretit (emigrimit profetik).

Beteja e Bedrit

H 2

Në Betejën e Bedrit muslimanët triumfojnë kundër idhujtarëve kurejsh dhe Kurani e quan atë "Dita e Dallimit" pasi ajo është beteja e parë në Islam që zhvillohet midis të vërtetës dhe të pavërtetës. Ndodhi më 17 ramazan të vitit 2 hixhri ose 13/3/624 e.s.

Përse u quajt Ramazan?

Gjatë periudhës së injorancës (para islame), kur arabët vendosën t'i bartin emrat e muajve nga gjuha e vjetër, i emërtuan ato sipas kohëve në të cilat ranë. Ky muaj i takoi të ishte në ditët e një të nxehti të madh ndaj u quajt

Ramadan (Ramazan) prej "Er-Ramda" që është vapa e fuqishme.

Gjithashtu muaji Rabia El-Euelu dhe Eth-Thani u emërtuan kësisoj sepse i takoi të ishin gjatë stinës së pranverës

Epopeja jonë në **Ramazan**

Ramazani është kremtuar përgjatë historisë me një sërë fitoresh dhe ngjarjesh historike, prej të cilave:

- **1260 e.s.** Beteja Ajn Xhalut
- **838 e.s.** Çlirimi i Amurijes (Amorium)
- **827 e.s.** Çlirimi i ishullit tëSicilisë
- **711 e.s.** Çlirimi i territoreve të Andaluzisë
- **630 e.s.** Çlirimi i Mekes
- **624 e.s.** Beteja e Bedrit; Ramazani i parë në të cilin obligohet agjërimi
- **13 e.s.** Zbritja e Kuranit

Projekti: Udhëzuesi i thjeshtuar i muslimanit **Këndvështrimi artistik:** Hasen Baharun **Projektim dhe realizim nga:** Kompania Ed-Delilu El-Muasir **Për më tepër referohuni në:** Libri "Lataif El-Mearif" **i Ibn Rexhebit** "Ahkemu El-Kuran" **i El-Kurtubiut** "Tefsir El-Kurani El-Adhim" **i Ibn Kethirit**

MODERN GUIDE